



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E HARTIMIT TË AKTEVE DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 3410 prot.

Tiranë, më 20.12 2023

URDHËR

Nr. 134, datë 20.12.2023

**“PËR
MIRATIMIN E PLANIT STRATEGJIK DHE PLANIT TË VEPRIMIT TË
ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 2023-2025”**

Në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e planit strategjik dhe planit të veprimit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë 2023-2025, sipas tekstit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Ngarkohen strukturat e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.
3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për publikimin në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

2023-2025

**PLANI STRATEGJIK DHE PLANI I VEPRIMIT
PËR ZYRËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
2023-2025**

Përmbajtja e lëndës

LISTA E SHKURTIMEVE

KREU I –HYRJE DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

1. Hyrje
2. Metodologjia

KREU II - ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1. Situata aktuale
2. Vlerësimi i riskut
3. Lidhja me dokumente të tjerë strategjikë

KREU III- VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIK

1. Vizioni, misioni, vlerat
2. Qasja e përgjithshme për objektivat strategjik

KREU IV - BURIMET FINANCIARE

1. Buxheti i shtetit

KREU V - MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Monitorimi
2. Raportimi

PLANI I VEPRIMIT 2023-2025

LISTA E SHKURTIMEVE

ILD	Inspektori i Lartë i Drejtësisë
KLQJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KM	Këshilli i Ministrave
MD	Ministria e Drejtësisë
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SND	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
SPI	Sistemi Planifikimi të Integruar
BE	Bashkimi Evropian
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
TIK	Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
KEV	Komisioni i Emërimit dhe Vlerësimit
MPI	Mbledhja e Përgjithshme e Inspektorëve
SP	Sekretari i Përgjithshëm
DHASHJ	Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike
DAS	Drejtoria e Analizës dhe Standardeve
DESHM	Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse
SBNJ	Spektori i Burimeve Njerëzore
SBF	Spektori i Buxhetit dhe Financës
SSHP	Spektori i Shërbimeve të Përgjithshme
STI	Spektori i Teknologjisë së Informacionit
SAMP	Spektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun
SAP	Spektori i Arkiv Protokollit
NJPS	Njësia Përgjegjëse për Sinjalizimin

KREU I - HYRJE DHE METODOLOGJIA E PËRDORUR

1. Hyrje

Plani Strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është hartuar si një dokument vijues i planit strategjik të mëparshëm. Plani strategjik 2020-2022, i cili edhe pse një plan ambicioz për një institucion të sapokrijuar me sfida të gjithanshme, duke filluar nga sigurimi i mjediseve të punës, mundësimi i logjistikës së nevojshme, plotësimi me burime njerëzore, vendosje të standardeve të punës në institucion, vendosje të urave të komunikimit dhe bashkëpunimit me organet e tjera dhe publikun, u hartua në vlerësim të përcaktimeve ligjore në fuqi dhe ndërthurjes së kapacitetit njerëzor të kohës, me vizionin dhe misionin për të përçuar me përgjegjshmëri dhe vendosmëri, prioritetet e punës për dy vitet në vijim. Kjo për t'i vendosur synime të qarta dhe objektiva konkrete të drejtimit të institucionit dhe fillimit të kuptimit në thelb të objektit të veprimtarisë me standarde.

Në këto vite të veprimtarisë, pavarësisht sfidave të njëpasnjëshme si nga faktorë të jashtëm ashtu edhe të brendshëm janë arritur rezultate të dukshme në drejtim të:

- Sigurimit të zbatimit të legjislacionit të ri të Reformës në Drejtësi;
- Vendosjes së standardeve të punës për të mbajtur sistemin nën kontroll dhe të përgjegjshëm për shkak të mosfunksionimit të institucioneve të mëparshme të procedimit disiplinor për një periudhë 3-vjeçare;
- Gjetjes së mekanizmave dhe përcaktimit të metodologjisë për administrimin dhe trajtimin e një numri të madh ankesash të prapambetura;
- Ngritjes së një platforme komunikimi me publikun, institucionet dhe mediat;
- Përthithjes së burimeve njerëzore dhe forcimit të kapaciteteve;
- Përcaktimit të kuadrit të brendshëm rregullator;
- Sigurimit të infrastrukturës së nevojshme mbështetëse;
- Kryerjes së hetimeve disiplinore dhe inspektimeve ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, në respektim të pavarësisë dhe parimit të ndarjes së pushteteve në përputhje me garancitë e parashikuara nga shteti i së drejtës;
- Përcaktimit të vizionit të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të balancuar interesin publik nga njëra anë dhe për të garantuar pavarësinë e gjyqësorit nga ana tjetër.

Në dallim nga plani strategjik 2020-2022, ky plan i ri, mbart përvojën dhe pjekurinë e arritur në sfidat e fillimit, si dhe vullnetin e vendosmërinë për të kthyer vështirësitë e hasura deri tani në objektiva pune, me qëllim për të arritur rezultate të dukshme e të matshme drejt rrugës së konsolidimit të veprimtarisë institucionale dhe për të guxuar në të ardhmen.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, tashmë ka arritur në një nivel tjetër të veprimtarisë së tij, atë të fuqizimit të veprimtarisë përmes kuptimit nga afër të problematikave të sistemit dhe gjetjes së mekanizmave për të adresuar zgjidhjet. Përcaktimi i njëjësive që ndjekin apo zbatojnë aktivitetet,

koordinimi në aktivitete me pikëprerje të përbashkët dhe monitorimi i zbatimit me tregues cilësorë dhe sasiorë, tregoi se lindi nevoja e zhvillimit të planit të ri strategjik drejt një dimensionit tjetër, atë të konsolidimit të përvojës me sfida të reja dhe fuqizimin e mëtejshëm të kapaciteteve për të arritur efekte domethënëse të performancës profesionale dhe institucionale, konkretisht:

- Krijimit të një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor;
- Matjes së performancës së magjistratëve, gjyqtarë/prokurorë, lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë;
- Forcimit të mekanizmave institucionalë për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor;
- Krijimit të sistemit të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e çështjeve dhe përmirësimin në vijimësi të kësaj infrastrukture;
- Rritjes së kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet praktikave të trajnimit dhe inspektimit me homologët evropianë;
- Kryerjes së inspektimeve të vazhdueshme tematike dhe institucionale të planifikuara, në zbatim të metodologjisë dhe standardeve përkatëse.

2. Metodologjia

Si pikënisje e hartimit të planit të ri strategjik, ka shërbyer analiza e ecurisë së zbatimit të planit strategjik, e cila është realizuar nga njësi përgjegjëse për monitorimin e planit strategjik. Kjo njësi ka monitoruar periodikisht realizimin e planit, sipas mënyrës së miratuar me urdhër të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për nivelin e përmbushjes së objektivave, brenda afateve të përcaktuara. Ky plan përfshin të gjithë ato aktivitete, të cilat kanë patur progres të ngadaltë apo realizim të ulët duke u ripunuar pas procesit të analizimit të secilit prej tyre.

Krahas analizës së brendshme, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe impaktit që ka patur roli i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në sistem, përmes standardeve të aplikuara në realizimin, verifikimin e ankesave dhe hetimin disiplinor, duke ruajtur me vendosmëri dhe respekt të plotë pavarësinë e magjistratëve nga njëra anë nëpërmjet verifikimeve të plota dhe të gjithanshme dhe nga ana tjetër ruajtjen e ekuilibrit dhe balancës aq të domosdoshme, mes interesave legjitime të publikut për të marrë një shërbim efektiv gjyqësor.

Përveç rezultateve të brendshme të punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, gjatë hartimit të planit të ri 2023-2025, janë marrë parasysh edhe rekomandimet e lëna në Rezolutën e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Këto rekomandime janë zbërthyer në masa konkrete me rezultate të matshme, të cilat për shkak të rëndësisë së tyre janë shpërndarë në disa aktivitete të rëndësishme që janë të detajuara në planin e ri strategjik.

Në kuadër të masave dhe aktiviteteve të përcaktuara janë marrë në konsideratë edhe nevojat e publikut për të kuptuar qasjen e performancës institucionale, kapaciteteve aktuale dhe vizionin për filozofinë e punës duke konceptuar një objektiv që lidhet me transparencën dhe aktivitete, të cilat do të bëhen publike sipas masave të përcaktuara në plan.

Në lidhje me metodologjinë e përdorur, procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit ka qenë gjithëpërfshirës, me kontributin e njëjësive kryesore të institucionit, konkretizuar me urdhrin nr. 63, datë 28.07.2022 “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit 2023-2025 të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”. Pas analizimit të ecurisë së zbatimit të planit strategjik dhe planit të veprimit për periudhën 2020-2022, si dhe referuar të gjithë dokumenteve strategjike, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë jep kontribut, grupi i punës ka identifikuar dhe parashtruar objektivat strategjike që do të mbahen në konsideratë në planin e ri strategjik për periudhën 2023-2025. Të gjitha këto gjetje u analizuan, përpunuan dhe u harmonizuan, duke u përfshirë në këtë plan si objektiva strategjike, specifike dhe masa apo aktivitete.

Krahas rezultateve të monitorimit të brendshëm, vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe faktorëve të jashtëm me ndikim në veprimtari, siç janë prioritet e vendosura në dokumente politike dhe strategjike, të cilat kanë ndikim direkt në veprimtarinë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Faktorët ekonomiko-socialë që po kalon vendi, diktojnë nevojën e angazhimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në procese integruese. Për këtë qëllim në zhvillimin e objektivave janë marrë në konsideratë edhe angazhime, që kanë dalë nga takimi dypalësh, mes krerëve të institucioneve të pavarura dhe përfaqësuesve të lartë të Komisionit Evropian, nga dokumente të rëndësishme si Progres Raporti i Bashkimit Evropian, Plani Kombëtar i Integritimit Evropian, rekomandimet e të cilave, nisur për nga rëndësia, janë vendosur si aktivitete të matshme në planin e ri strategjik.

Gjithashtu, Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021-2025, diktoi nevojën e përfshirjes së masave të reja në planin strategjik të Zyrës, masa, të cilat do të vijojnë të jenë pjesë e planit strategjik 2023-2025.

Plani strategjik, është hartuar në mbështetje të kornizës së sistemit të integruar të politikave, përmes së cilës synohet koordinim i politikave të brendshme, planifikim i tyre, monitorim përmes rezultateve të matshme, ndjekje e ecurisë së zbatimit dhe transparencës, duke publikuar raporte periodike monitorimi. Të gjithë komponentët e këtij sistemi të integruar synojnë një menaxhim efikas të performancës dhe rezultateve nëpërmjet evidentimit të rezultateve të arritura, duke rritur kështu cilësinë e drejtimit të veprimtarisë dhe llogaridhënies së njëjësive.

Zbatimi i planit strategjik të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe planit të veprimit 2023-2025 të tij, do të sigurohet, sikurse dhe plani 2020-2022, nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave, masave apo aktiviteteve të planifikuara.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të:

- nivelit të zbatimit të planit strategjik, sipas afateve të parashikuara në planin e veprimit;
- raportimit periodik të secilit aktivitet apo masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo moszhvillimin e atyre të planifikuara;
- harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjikë dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2023-2025.

Ndërkohë raportimi i zbatimit të planit të veprimit do të realizohet në baza periodike 6-mujore bazuar në të dhënat e njësive organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë e përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

Objektivat prioritare të vendosura në strategjinë dhe planin strategjik 2023-2025 do të kontribuojnë në konsolidimin dhe fuqizimin e funksioneve dhe objektivave të punës së institucionit duke u orientuar drejt efikasitetit funksional, bashkëpunimit dhe koordinimit midis njësive të Zyrës së Inspektorit të lartë të Drejtësisë.

KREU II - ANALIZA E SITUATËS AKTUALE

1. Situata aktuale

Inspektori i Lartë i Drejtësisë në cilësinë e autoritetit shtetëror përgjegjës për verifikimin e ankesave, hetimin e shkeljeve disiplinore dhe nisjen e procedimit disiplinor ndaj magistratëve ka administruar dhe shqyrtuar një numër të madh ankesash, lidhur me veprimtarinë e magistratëve, të ardhura drejtpërdrejt në institucion, por edhe të ankesave të depozituara pranë institucioneve të tjera para fillimit të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (backlog) si dhe inspektimet tematike dhe institucionale.

Sa i përket procedurës së shqyrtimit, verifikimit dhe hetimit disiplinor, për 3 vitet e shkuara janë depozituar 2996 ankesa të reja në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Këtij numri i shtohet edhe fondi prej 2104 ankesa backlog (të ardhura në vitet paraardhëse dhe atyre të përcjella nga institucionet ekzistuese para hyrjes në fuqi të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”). Për periudhën 3 vjeçare, ILD ka pasur në shqyrtim 5100 ankesa dhe gjatë të njëjtës periudhë ka shqyrtuar 3606 ankesa me vendimmarrje arkivimi. Nga 3606 ankesa të shqyrtuara, 1032 i përkasin fondit backlog. Deri në 31 dhjetor 2022, në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë kanë qenë në proces shqyrtimi 1752 ankesa të mbartura nga vitet e mëparshme, si dhe 1072 ankesa backlog.

Sa i përket vendimeve të fillimit të hetimit për këto tre vite, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka miratuar 58 vendime hetimi disiplinor, ku janë konstatuar shkelje për 80 magistratë dhe 3 anëtarë Këshilli. Nga 83 subjekte të hetimit disiplinor, për 27 prej tyre është vijuar me paraqitjen e kërkesave për procedim pranë këshillave përkatës. Koncretisht 16 kërkesa të depozituara në KLGJ dhe 11 kërkesa të depozituara në KLP. Sa i takon vendimmarrjes së këshillave në lidhje me këto kërkesa, nga ana e KLGJ-së 4 kërkesa janë pranuar, 2 kërkesa janë mbyllur pa vendim (për shkak të mbarimit të statusit), 3 kërkesa janë pranuar pjesërisht (ndryshuar masa disiplinore), 1 kërkesë është me marrëveshje të përbashkët pranimi, 5 kërkesa janë pezulluar për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar dhe 1 kërkesë është në proces. Nga ana e KLP-së, 7 kërkesa janë pranuar, 2 kërkesa janë rrëzuar, 1 kërkesë është pezulluar dhe 1 është në proces.

Rezultatet e mësipërme të ecurisë së punës, tregojnë profesionalizëm dhe efektivitet në shqyrtimin e ankesave, trajtimin dhe verifikimin e shkeljeve disiplinore, jo vetëm si një detyrim ligjor, por edhe me standarde. Gjatë këtyre viteve të veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, si strukturë e vetme në zhvillimin e procesit të hetimit dhe fillimit të procedimit disiplinor, dhe e ndarë nga procesi vendimmarrës për dhënien e masës disiplinore është kryer hetimi dhe procedimi disiplinor ndaj magistratëve në bazë të parimeve dhe standardeve të një procesi të rregullt ligjor. Standardet e vendosura nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë për procedimet disiplinore janë të konfirmuara jo vetëm nga Këshillat, duke mos pasur asnjë

vendim arkivimi të ankesës, apo mbyllje hetimi të cenuar dhe as nga praktika gjyqësore e gjykatave të apelit apo nga praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese. Kjo ka arritur në përfundimin e qartë se procedurat e ndjekura gjatë hetimit dhe procedimit disiplinor janë kryer në respektim të të drejtave të magjistratëve dhe në kuadër të një procesi të rregullt ligjor.

Përveç shqyrtimit të ankesave dhe hetimeve disiplinore, një funksion tjetër shumë i rëndësishëm është inspektimi. Inspektimi në gjykata dhe prokurori është mjet i rëndësishëm me karakter njohës dhe konstatues të efektivitetit të veprimtarisë së organeve, me synim nxitjen e përmirësimit e vazhdueshëm në funksion të administrimit të drejtësisë.

Ndërmarrja e inspektimeve tematike ka për qëllim krijimin e një sistemi llogaridhënës funksional mbështetur në standardet e përgjegjshmërisë dhe përgjegjësisë së magjistratëve. Angazhimi i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në procese thelbësore kontrolli lidhur me veprimtarinë e magjistratëve në aspekt të cilësisë dhe efikasitetit të dhënies së drejtësisë, është prioritet i ILD-së, për identifikimin e problematikave, që ka sistemi, pa pasur qëllim në vetvete masat disiplinore ndaj magjistratëve, por për të kontribuar në performancën e sistemit të drejtësisë, në shërbim të interesave të publikut, duke iu përgjigjur në kohë dhe paanshmëri nevojave të shoqërisë.

Aktualisht ILD ka përfunduar 3 inspektime dhe është në proces të kryerjes së katër inspektimeve tematike pranë gjykatave dhe zyrave të prokurorisë. Synimi primar i këtyre inspektimeve tematike, ka qenë konstatimi i problematikave në sistem dhe rekomandimi i zgjidhjeve, të cilat pritet t'i shërbejnë përmirësimit të punës së prokurorive dhe gjykatave. Konkretisht, në lidhje me inspektimet, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer tre inspektime tematike që kanë patur si objekt:

- Evidentimin e mënyrës së interpretimit, respektimit të kushteve dhe kriterëve për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyese dhe municionit”, nga prokurorët. Në përfundim të inspektimit janë nxjerrë rekomandime për organet kompetente për të marrë masa me karakter rregullator, përmes ndryshimeve ligjore dhe nxjerrjes së akteve nënligjore në kompetencë të tyre për caktimin e masave të sigurimit personal për veprën penale të “Mbajtjes pa leje dhe prodhimit të armëve, armëve shpërthyese dhe municionit”. Njëkohësisht janë propozuar edhe masa të karakterit administrativ, duke propozuar sesione trajnimit për garancitë kushtetuese e konventore të lirisë personale, unifikimit të praktikave në të gjitha prokuroritë dhe rritjen e cilësisë së magjistratëve, përmes ofrimit të trajnimeve vazhduese.
- Zbatimin e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrjen për çështje konkrete.

- Vlerësimin e praktikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, lidhur me zbatimin e kriterëve ligjore mbi shpalljen dhe depozitim të vendimeve gjyqësore të arsyetuara në sekretari. Në përfundim të inspektimit janë nxjerrë rekomandime për organet kompetente për të marrë masa me karakter administrativ dhe zbatim të kërkesave procedurale për njoftimin e vendimeve përfundimtare, jopërfundimtare dhe të ndërmjetme të gjykatës, për të cilat është parashikuar e drejta e ankimit nga Kodi i Procedurës Civile. Gjithashtu janë nxjerrë rekomandime për fillimin e verifikimeve në kuadër të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar, për të konstatuar nëse ka fakte të mjaftueshme për fillimin e hetimit disiplinor ndaj disa magistratëve.
- Zbatimin e institutit të “Lirimit me kusht”, nga gjyqtarët dhe prokurorët. Rezultatet e këtij inspektimi, kanë sjellë përgjegjësi penale e disiplinore për disa magistratë. Por nga ana tjetër ka rezultuar me rritje të ndërgjegjësimit dhe vigjilencës në aplikimin e këtij instituti, duke rritur efektivisht cilësinë në drejtim të zbatimit të këtij instituti.

Gjithashtu, objekt i punës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është edhe konsolidimi i akteve rregullatore të veprimtarisë, me qëllim forcimin dhe zhvillimin e brendshëm të proceseve të punës si dhe ushtrimin e veprimtarisë së tij në mënyrë të pavarur, eficiente, profesionale, si dhe sa më transparente dhe të besueshme ndaj publikut. Për këtë qëllim, janë hartuar aktet e nevojshme në zbatim të ligjit, si edhe janë rishikuar ato akte, të cilat lidhen me konsolidimin e rregullave të brendshme të veprimtarisë, pas kryerjes së analizave të ushtrimit të veprimtarisë, por edhe sa herë që diktohen nga ndryshimet ligjore, apo si nevojë e zbatimit në praktikë.

Për sa i takon plotësimin të strukturës organike komandimi dhe emërimi i inspektorëve, ka qenë një ndër sfidat që ka marrë vëmendje të veçantë nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë. Për të mundësuar kapacitetin e njësisë inspektuese, janë paraqitur kërkesa të vazhdueshme pranë Këshillave për komandim të magistratëve në pozicionet e inspektorëve magistratë dhe shpallja e vendeve të lira për pozicionet inspektorë jomagjistratë. Sipas strukturës së miratuar me vendim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka një numër prej 20 inspektorësh, me ndarje të barabartë pozicionesh për magistratë dhe jomagjistratë. Aktualisht, ushtrojnë detyrën 3 inspektorë magistratë të komanduar nga Këshillat dhe 6 inspektorë jomagjistratë të emëruar, pas një procedure përzgjedhëse konkurruese, nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë.

Në të njëjtën kohë, në fokus të punës ka qenë dhe do të vazhdojë të jetë rritja e standardeve me qëllim zhvillimin e procesit hetimor disiplinor në përputhje me parimet e ligjshmërisë e të procesit të rregullt ligjor sipas standardeve ndërkombëtare, përmes ndjekjes së aktiviteteve trajnuese, pjesëmarrjes aktive në forume profesionale dhe zhvillimin e vizitave studimore në inspektoratet homologe evropiane.

Në drejtim të rritjes së kapaciteteve Inspektori i Lartë i Drejtësisë vijon përpjekjet për të gjetur dhe mundësuar zhvillimin e vazhdueshëm profesional të kapaciteteve njerëzore. Viti 2021, ishte një vit me arritje konkrete për sa i takon rritjes së kapaciteteve, duke filluar me vendosjen e kontakteve me partnerë ndërkombëtarë për bashkëpunimin në shkëmbimin e eksperiencave e praktikave për hetimin e shkeljeve disiplinore dhe inspektimeve për çështje me interes të përbashkët, por edhe marrja e statusit si vend vëzhgues në Rrjetin Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë (RESIJ).

Fillimi i bashkëpunimit me partnerët ndërkombëtarë gjatë viteve 2021-2022, vijoi me nënshkrimin e disa memorandumeve të mirëkuptimit¹, në zbatim të të cilave u zhvilluan disa vizita të rëndësishme pune, të cilat kanë pasur si objekt njohjen me eksperiencën e punës dhe me reformat e ndërmarra në drejtësi nga Republika e Rumanisë², si një zhvillim të ngjashëm me reformën e sistemit të drejtësisë në Shqipëri. Po kështu, vizitë e rëndësishme në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ishte edhe vizita e zhvilluar në Inspektoratin e Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë³, përmes së cilës u paraqitën kompetencat dhe përbërja e institucionit, duke u ndalur në procedurat e kryerjes së inspektimeve tematike dhe inspektimeve të planifikuara, inspektimeve të integritetit dhe të pasurisë së magjistratëve, inspektimeve në rast të pretendimeve për zvarritje të proceseve gjyqësore dhe inspektimeve mbi përdorimin e të dhënave personale dhe efikasitetin e sistemeve të teknologjisë së informacionit për regjistrin e ankesave. Një tjetër bashkëpunim i frytshëm ishte edhe pjesëmarrja në një procedurë inspektimi pranë Gjykatës së Apelit në Romë, në kuadër të aktiviteteve të parashikuara nga Memorandumi i Bashkëpunimit mes Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Ministrinë e Drejtësisë së Republikës së Italisë, përfaqësuar nga kreu i Inspektoratit të Përgjithshëm Italian.

Nga anëtarësimi si vend vëzhgues në RESIJ, u vijua me organizimin e disa aktiviteteve të rëndësishme, siç janë zhvillimi i konferencës ndërkombëtare mbajtur në Tiranë në datat 24 dhe 25 Qershor 2022, organizuar nga RESIJ dhe Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në bashkëpunim me CEPEJ, me mbështetjen e programit të përbashkët të Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "Instrumenti horizontal II". Në këtë konferencë ndërkombëtare u bënë bashkë drejtues dhe përfaqësues të shërbimeve të inspektimit të drejtësisë të vendeve të Bashkimit Evropian,

¹ Nënshkrimi i Memorandumit të mirëkuptimit me drejtuesen e Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Italisë, Znj. Maria Rosaria Covelli, me synim fuqizimin e marrëdhënieve ndërinstitucionale dhe shkëmbimin e praktikave më të mira, në kuadër të procedurave të inspektimit dhe hetimit disiplinor ndaj magjistratëve. Nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit me Presidenten e Këshillit të Shtetit të Greqisë përfaqësuar nga znj. Evangelia Nika

² Vizitë pune me funksionarë të lartë dhe drejtues të Inspektoratit të Gjyqësor në Rumani, e aksesueshme në linkun: <https://ild.al/sq/2022/02/07/inspektori-i-larte-i-drejtësisë-vizite-pune-ne-rumani/>

³ Vizitë pune me ftesë të homologes Znj. Teodora Tochkova, Inspektor i Lartë i Inspektoratit të Këshillit të Lartë Gjyqësor të Republikës së Bullgarisë, e aksesueshme në linkun: <https://ild.al/sq/2022/06/08/inspektori-i-larte-i-drejtësisë-artur-metani-zhvillon-vizite-pune-ne-bullgari/>

anëtarë të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë⁴, të cilët pavarësisht nga forma e organizimit, funksionimit apo kompetencave të cilat ushtrojnë, kanë prezantuar dhe shkëmbyer eksperiencat, idetë dhe kërkimet e tyre, lidhur me temën "Interesi i publikut në administrimin e drejtësisë dhe pavarësia e magjistratëve". Aktivitet tjetër vijues gjatë 2023 i rëndësishëm në sajë të bashkëpunimit ndërkombëtar me RESIJ, është trajnimi dy ditor me ekipin e ILD-së, me mbështetjen e CEPEJ, projektit të përbashkët të Bashkimit Evropian/Këshillit të Evropës për Drejtësinë. Në dy ditët e trajnimit, inspektorët francezë bënë një prezantim të Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë së Francës, me fokus tek inspektimet tematike dhe mbështetëse, kontrollat operative dhe standardet e referimeve, metodologjinë e inspektimeve, hetimet administrative ndaj magjistratëve, duke diskutuar mbi raste konkrete.

Thellimi i bashkëpunimit me RESIJ, si me konferencat e trajnimit, ashtu edhe materialet përgatitore për të prezantuar punën e ILD-së, kanë ndikuar në krijimin e partneritetit profesional ndërkombëtar të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke shënuar një tjetër arritje të rëndësishme, duke pranuar Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, anëtar me të drejta të plota të Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Drejtësisë.

Pas dy vitesh me statusin e anëtarit vëzhgues, në Asamblenë e Përgjithshme të mbajtur në muajin tetor 2023, nën drejtimin e Rumanisë, të gjithë anëtarët unanimisht u shprehën pro propozimit të Rumanisë, për anëtarësimin e ILD-së me statusin e anëtarit me të drejta të plota në RESIJ. Në kuadër të anëtarësimit në RESIJ, është mbajtur në Tiranë, më datë 14.12.2023, Asambleja e Përgjithshme e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit (RESIJ) për të diskutuar dhe miratuar ndryshime të statutit RESIJ 2. Në fokus të takimit kanë qenë edhe ndryshimi i një sërë dokumentesh dhe aktesh rregullatore që normojnë veprimtarinë e këtij rrjeti.

Rritja e transparencës me publikun, por edhe ndërgjegjësimi mbi rolin e institucionit, konsiderohen si një aspekt shumë i rëndësishëm i punës, pasi marrëdhënia me publikun shihet, si një nga mënyrat më efektive, jo vetëm për të garantuar besimin e publikut tek institucioni në veçanti, por edhe tek drejtësia në përgjithësi. Numri i lartë i ankesave të trashëguara, por edhe fluksi i atyre të ardhura në institucion, janë dëshmi se sistemi i drejtësisë ka pasur problematika të shumëllojshme. Me vizionin se rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë është vlerë e rëndësishme për progresin e shoqërisë, publikimi i rezultateve konkrete të veprimtarisë në kohë reale dhe pasurimi i të dhënave në mënyrë të vazhdueshme është një hap dobiprurës në forcimin e besimit të publikut, ndaj edhe faqja e internetit të institucionit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është platforma kryesore e komunikimit të zhvillimeve të aktivitetit, por edhe ndërgjegjësimit të publikut për rolin dhe misionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

⁴ Pjesëmarrës të Shërbimeve të Inspektimit të Belgjikës, Bullgarisë, Francës, Greqisë, Italisë, Portugalisë, Rumanisë, Spanjës dhe Shqipërisë, kanë diskutuar dhe mbajtur prezantime në tre sesione. Të dhënat e konferencës gjenden të aksesueshme në linkun: <https://conference.ild.al/home-al.html#header>

Në faqen zyrtare ka informacion të detajuar mbi mënyrën se si mund të paraqitet një ankesë në ILD dhe jepen opsionet e paraqitjes së ankesave të shpjeguara në mënyrë të detajuar, përmes plotësimit të formularit tip të ankesave, shoqëruar me udhëzuesin për plotësimin e tij dhe një model të plotësuar për orientim. Për të lehtësuar më tej këtë proces, në faqe gjenden edhe shembuj të pranueshmërisë apo jo të ankesës dhe raste konkrete për të ndihmuar ankuesit me kriteret që duhet të plotësojë një ankesë.

Nga ana tjetër, stafi i sektorit të ankesave të ILD-së ofron asistencë për ankuesit përmes pritjes fizike të ankuesve dhe përgjigjes së telefonatave çdo ditë të javës. Parashikimi i një ambienti të dedikuar për pritjen fizike të qytetarëve, duke krijuar lehtësira të mëtejshme në plotësimin e formularëve dhe dhënien e sqarimeve të nevojshme është një prioritet i caktuar që në planin strategjik 2020-2022 dhe vazhdues për planin e ri të hartuar.

Në funksion të ndërgjegjësimit të opinionit publik lidhur me funksionet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë firmosur disa memorandume me fakultetet e drejtësisë, që kanë për qëllim njohjen nga studentët e drejtësisë të rolit dhe funksioneve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Në aspektin e teknologjisë së informacionit, mbështetja e vazhdueshme e partnerëve ndërkombëtarë u finalizua me ngritjen e një sistemi të brendshëm të menaxhimit të dokumentacionit (SMAD), i cili është një bazë fillestare për digjitalizimin e proceseve të punës, gjenerimin e raporteve statistikore.

Me fillimin e veprimtarisë së punës së QTI-së, zhvillimi i teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë do të jetë i harmonizuar me objektivat e përgjithshme shtetërore për sistemet e teknologjisë së informacionit, sipas sistemit të integruar të drejtësisë elektronike (e-drejtësia). Qasja në projektet teknologjike do të jetë e unifikuar, për sistemet e menaxhimit të çështjeve që do të ngrihen pranë gjykatave dhe prokurorive, duke mundësuar lidhjen me regjistrat dhe bazat e të dhënave përkatëse kombëtare dhe akses të plotë në përputhje me veprimtarinë hetimore dhe inspektuese.

Në përmbledhje të punës së deritanishme, Inspektori i Lartë i Drejtësisë, me ngarkesë të theksuar për shkak të mungesave në kapaciteteve njerëzore e infrastrukturore, por në sajë të objektivave të vendosura dhe të matshme, ka arritur prioritetet kryesore, ku në mënyrë të përmbledhur përmendim:

- Trajtimin e ankesave dhe vazhdimin e punës me procedimet në faza të ndryshme shqyrtimi nga organet e mëparshme;
- Përfundimin e trajtimit të ankesave të trashëguara për të ulur numrin e ankesave të akumuluar, sipas një radhe përparësie bazuar në respektimin e parimit të barazisë dhe objektivitetit;
- Realizimin e një numri të lartë të hetimeve dhe procedimeve disiplinore, pavarësisht mungesës prej 11 inspektorësh;

- Përmbylljen e tre inspektimeve tematike, rezultatet e të cilave kanë dhënë efektet e synuara;
- Përcaktimin e rregullave dhe procedurave të brendshme të punës për ushtrimin e detyrave funksionale dhe miradministrimin e institucionit;
- Rritjen e bashkëpunimit me aktorë ndërkombëtarë dhe shoqërinë civile;
- Rritjen e transparencës së veprimtarisë përmes përmirësimit dhe pasurimit të informacionit në dispozicion për publikun e gjerë.

Përvoja e përfituar, tërësia e masave të ndërmarra, koordinimi i veprimtarisë dhe ndërthurja me objektiva të rëndësishëm strategjikë, të miratuar me Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021-2025, prioritetet kombëtare dhe standardet evropiane, kanë shërbyer si gur themeli në përcaktimin e objektivave afatgjatë dhe afatshkurtër, të cilat do të orientojnë punën në vijim. Në këtë drejtim për tre vitet në vazhdim prioritetet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë janë:

- Krijimi i një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit gjyqësor;
- Matja e performancës së magistratëve, gjyqtarë/prokurorë, lidhur me cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë;
- Forcimi i mekanizmave institucionalë për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të subjekteve të procedimit disiplinor;
- Krijimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për menaxhimin e çështjeve dhe përmirësimin në vijimësi të kësaj infrastrukture;
- Rritja e kapaciteteve të inspektorëve nëpërmjet praktikave të trajnimit dhe inspektimit me homologët evropianë;
- Kryerja e inspektimeve të vazhdueshme tematike dhe institucionale të planifikuara, në zbatim të metodologjisë dhe standardeve përkatëse.

Duke bërë bashkë të gjithë çështjet e shtruar më sipër, për tre vitet në vijim propozohen këto objektiva strategjikë të punës, të cilat do të kenë për qëllim:

- Konsolidimin e veprimtarisë në mënyrë të pavarur, efëcente dhe profesionale;
- Fuqizimin e veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane;
- Zhvillimin e sistemit të teknologjisë për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- Rritjen e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e ILD-së.

Strategjia shoqërohet me planin e veprimit, i cili përmban përpunim të detajuar të objektivave në aktivitete të matshme dhe veprime në lidhje me kohën, cilësinë dhe koston financiare.

2. Vlerësimi i riskut


Procesi i hartimit të strategjisë dhe planit të veprimit është realizuar duke mbajtur në konsideratë kombinimin e përparësive me mundësitë që institucioni ka në dispozicion, si dhe eliminimin e dobësive të institucionit dhe shmangien e rreziqeve potenciale.

Metoda e përdorur për të vlerësuar riskun në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, lidhet me analizimin e faktorëve potencialë të riskut me të cilat përballlet institucioni, me ndikim të brendshëm nga proceset e punës, por edhe nga faktorë të jashtëm.

Në vlerësim të riskut potencial është aplikuar analiza SWOT (Fuqitë-Dobësitë-Mundësitë-Risqet), ku janë ndërlidhur kapacitetet e brendshme dhe mangësitë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me kërkesat dhe sfidat e jashtme me të cilat mund të përballlet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij.

Në këto kushte, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë gjatë hartimit të planit strategjik 2023-2025, në parashikimin e objektivave të tij, ka zhvilluar analizën e mëposhtme:

SWOT Analysis



Në analizën e riskut, është parashikuar edhe matrica përkatëse e vlerësimit të tij, e cila është përgatitur sipas riskut të identifikuar nga dobësitë dhe kërcënimet e mundshme në rast të mosarritjes së objektivave, duke përfshirë një vlerësim të probabilitetit të ndodhjes së riskut, ndikimin e mundshëm të rrezikut si dhe propozimin për veprime lehtësuese për të shmangur ndodhjen e rrezikut ose për ta zbutur atë nëse ndodh.

3. Lidhja me dokumente të tjerë strategjikë

Plani strategjik i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është harmonizuar me qëllimet dhe masat e parashikuara në disa dokumente strategjike, duke mbajtur në konsideratë edhe përmbushjen e standardeve lidhur me procesin e integritit evropian. Ky proces është realizuar nëpërmjet kombinimit të veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me atë të qëllimeve strategjike dhe politikave qeverisëse për sektorin, por edhe të proceseve integruese të vendit duke bërë të mundur arritjen e synimeve të përbashkëta drejt forcimit dhe konsolidimit të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmin nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për të verifikuar dhe hetuar në mënyrë efektive numrin e madh të backlog-ut (ankesave të mbartura), por edhe për trajtimin e ankesave të depozituara në ILD, për garantimin e vazhdimësisë institucionale me qëllim ruajtjen e standardeve të përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë së sistemit të drejtësisë.

Objektivat strategjikë dhe plani në zbatim të tyre përputhet me objektivat e përcaktuar në këto dokumente:

- Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2021-2030⁵, si dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror drejt integritit në Bashkimin Evropian, paraqet se si do të arrihet integrimi Evropian përmes politikave dhe përparësive, sipas të cilit, për sistemin e drejtësisë prioritet është arritja e standardeve që u shërbejnë individëve, duke forcuar pavarësinë, efikasitetin dhe llogaridhënien e institucioneve gjyqësore, në mënyrë që të sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe rritjen e mirëqenies së tyre. SKZHIE ka disa shtylla dhe sipas prioritetit për shtyllën e parë të SKZHIE III “Demokraci të institucioneve dhe qeverisjes së mirë”, parashikohet prioriteti strategjik për *“nevojën e forcimit të mëtejshëm të institucioneve të sistemit të drejtësisë në veçanti si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit, duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Funkcionimi i sistemit të drejtësisë, modernizimi i shërbimeve publike dhe digjitalizimi, arritja e standardeve të BE-së në administratën publike, lufta ndaj korrupsionit dhe sigurimi i llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, zgjerimi i decentralizimit dhe demokracisë vendore si dhe përfshirja e*

⁵ Miratuar me vendimin nr. 88, datë 22.02.2023, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030”.

qytetarëve dhe shoqërisë civile në këto procese mbeten përparësi kyçe të mirëqeverisjes për Shqipërinë”.

Për periudhën e implementimit të SKZHIE III, prioritet mbetet konsolidimi i ndryshimeve ligjore dhe institucionale, si një kriter matës për pavarësinë e organeve të sistemit. Krahas forcimit të institucioneve, rëndësi i kushtohet eliminimit të *backlog*-ut dhe zhvillimit të qasjes ndaj dhënies së shërbimit me standarde duke përmirësuar infrastrukturën dhe digjitalizimin e sistemit të drejtësisë, si një mjet me ndikim në rritjen e efikasitetit, llogaridhënies, forcimit të besimit të publikut dhe transparencës në këtë sektor.

- Strategjia Ndërsektoriale e Sistemit të Drejtësisë 2021-2025⁶ (SND II), si strategjia që bën bashkë politikat prioritare për institucionet e pavarura dhe nën frymën e kohezionit institucional synojnë arritjen e katër 4 qëllimeve politike:

-Qëllimi i parë: Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, eficientën dhe llogaridhënien;

- Qëllimi i dytë: Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet evropiane;

-Qëllimi i tretë: Një sistem i drejtësisë penale i mbështetur në parimet moderne evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;

- Qëllimi i katërt: Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjithë institucione e sektorit.

SND II synon të konsolidojë kuadrin ligjor dhe institucional të sistemit të drejtësisë, të përfshijë praktikat moderne evropiane në drejtësinë penale, të përmirësojë infrastrukturën e sistemit të drejtësisë dhe të ofrojë zgjidhje për IT-në, duke përfshirë këtu zgjidhjet inovative elektronike që mbështesin rritjen thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sektorin e drejtësisë.

- Progres-raporti i Komisionit Evropian për vitin 2022, sipas të cilit: [*...Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD) ka vazhduar të jetë plotësisht funksional, duke nisur dhe kryer hetime disiplinore ndaj magjistratëve. ILD vazhdoi të kishte mungesë të personelit dhe nuk mundi të zvogëlonte ngarkesën e akumuluar, pavarësisht ndarjes së personelit dhe ambienteve shtesë dhe rritjes së buxhetit. Rekrutimi i inspektorëve shtesë dhe përmirësimi i kapaciteteve të ILD-së mbeten të nevojshme*]⁷, por edhe Progres-raporti i

⁶ Miratuar me vendimin nr. 823, datë 24.12.2021, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë 2021–2025, të planit të saj të veprimit”

⁷ <https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2022-10/Albania%20Report%202022.pdf> f.19

Komisionit Evropian për vitin 2023, sërish konstaton si çështje prioritare rekrutimin e inspektorëve në funksion të nevojës për të përmirësuar kapacitetet e ILD-së⁸.

Progres-raporti i Komisionit Evropian, përmes përfundimeve të vlerësimit për sistemin e drejtësisë, rekomandon ngritjen e një sistemi modern të Integruar të Menaxhimit të Çështjeve për sistemin, e ndërsa veçanërisht për ILD-në, evidenton se prioritet duhet të jenë rekrutimet dhe përmirësimi i kapaciteteve.

- Plani Kombëtar i integritit European 2022-2024⁹

Plani Kombëtar i Integritit European 2022-2024 si dokumenti me masa konkrete afatmesme dhe afatgjata, për përafrimin e plotë ligjor të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së dhe harmonizimin e të gjithë sektorëve me standardet e përcaktuara në kapitujt e *acquis*, ka përcaktuar një sërë masash në nivel kombëtar që synohen për t'u përafruar. Përveç masave me karakter normativ, ky plan shtrin fushëveprimin e tij edhe tek prioritetet e tjera me natyrë funksionale dhe administrative, të cilat ndikojnë në arritjen e objektivave të vendosur në plan. Duke qenë se Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në këtë fazë të procesit të hartimit të planit strategjik, nuk ka akte për përafrim, por në aspektin funksional, prioritet i lartë mbetet rekrutimi i inspektorëve, duke qenë se plotësimi i vendeve vakant për inspektorë, veçanërisht përthithjes së kapaciteteve të magistratëve, mbetet ende një sfidë.

- Takimi dypalësh, Bashkim Evropian-Shqipëri, në Bruksel¹⁰, për Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”.

Pjesëmarrja në takimin dy palësh BE-Shqipëri, ku Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka parashtruar gjendjen dhe problematikat e sistemit llogaridhënës në Bruksel, në kuadër të proceseve të diktuar nga Kapitullin 23, “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, me fokus funksionet e ILD-së, të dhëna statistikore për shqyrtimin e ankesave, hetimet dhe procedimet disiplinore, si dhe rezultatet e kërkesave për procedim dhe inspektimet. Gjithashtu, në takim u diskutuan edhe nën tematika që adresojnë edhe aspekte të administrimit të përgjithshëm të veprimtarisë, si buxheti, struktura, burimet njerëzore, pavarësia, duke përfshirë zgjedhjen, mbarimin e mandatit, papajtueshmërinë dhe përgjegjësinë disiplinore të ILD-së. Gjatë takimit, ILD prezantoi prioritetet afatshkurtra dhe afatgjata të veprimtarisë, të cilat janë përcaktuar në objektiva specifike dhe masa të matshme në këtë plan. Prioritetet e ILD-së janë njëkohësisht të harmonizuara edhe Udhërrëfyesit për Shtetin e së Drejtës¹¹, si një ndër dy pikat e hapjes së

⁸ https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/system/files/2023-11/SWD_2023_690%20Albania%20report.pdf f.21

⁹ Vendim nr. 91, datë 9.2.2022, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e planit kombëtar të Integritit European”

¹⁰ Takim Bilateral BE- Shqipëri, i mbajtur, në Bruksel në datat 24-25 nëntor 2022

¹¹ Në fazën e hartimit të këtij dokumenti strategjik, Udhërrëfyesi për shtetin e së drejtës është një në faze punimi.

diskutimeve të grupkapitujve për të drejtat themelore (*opening benchmark*), si dokumenti kyç në politikat e integritit Evropian.

Nën optikën e dokumenteve të sipërpërmendur referuar dhe objektit të veprimtarisë, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka vendosur objektiva strategjike për tre vitet e ardhshme të ndërthura në funksion të konsolidimit të veprimtarisë, që lidhet me zbatimin me paanshmëri dhe objektivitet të kuadrit ligjor të veprimtarisë, përcaktimin e organizimit strukturor dhe funksional, plotësimin e vendeve vakante, gjetjen e zgjidhjeve potenciale për të adresuar çdo problematikë në përmbushje të funksioneve përmes rishikimit të kuadrit rregullator, apo zhvillimin profesional. Nëpërmjet masave të parashikuara në dokumentin strategjik dhe planin e tij të veprimit synohet qëndrueshmëria, profesionalizmi i njësisë së inspektorëve, duke bashkëpunuar me partnerët ndërkombëtarë në funksion të konsolidimit të veprimtarisë dhe kryerjes së procedurave të verifikuese dhe inspektuese në zbatim të standardeve evropiane dhe legjislacionit në fuqi.

Në të njëjtë kohë, përparësi i jepet përmirësimit të efikasitetit në sajë të zhvillimit të teknologjisë, përmes bashkëpunimit me Qendrën e Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë, për zhvillimin e sistemit elektronik të teknologjisë së informacionit për përdorim në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për menaxhimin, koordinimin, monitorimin dhe mbikëqyrjen e përdorimit të teknologjisë së informacionit. Ky sistem do të zhvillohet në kuadër të politikave të bashkëpunimit ndërinstitucional të organeve të sistemit të drejtësisë, nën organizimin e punës përmes Qendrës së Teknologjisë së Informacionit për Sistemin e Drejtësisë.

Aplikimi i sistemit të teknologjisë, është parashikuar si objektiv strategjik në mbështetje të veprimtarisë të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Realizimi do të jetë nëpërmjet kombinimit të aplikimit të metodave të punës dhe mjeteve të teknologjisë së informacionit, në përmbushje të parashikimeve ligjore. Sa i takon ngritjes së tij, sistemi do të mundësojë dhe lehtësojë komunikimin e ndërveprimin me organet kompetente, përpunimin dhe transmetimin e informacionit, rritjen e efikasitetit duke ulur kohën për të marrë të dhënat e nevojshme nga gjykatat dhe prokuroritë apo qarkullimin e brendshëm të dokumentacionit, dhe gjenerimin e raporteve statistikore në kohë reale. Aplikimi i sistemit të teknologjisë së informacionit do të jetë sipas koordinimit të projekteve TI, mes organeve të sistemit të drejtësisë, në funksion të arritjes së standardeve për përputhshmërinë e sistemeve, për të mundësuar komunikimin, administrimin dhe mirëmbajtjen, sipas nevojave specifike të secilit institucion të sistemit të drejtësisë. Në të njëjtën kohë, sistemi i teknologjisë së informacionit do të përmbushë nevojat e sigurisë teknike veçanërisht për sigurinë kibernetike, integritetin, paprekshmërinë dhe mbrojtjen e sistemeve. Për këtë qëllim përfshirja e masave konkrete për zhvillimin e teknologjisë, duke filluar me pajisjen e infrastrukturës së nevojshme që ka të bëjë me zhvillimin e Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve, si një sistem bashkëkohor me synimin për të digjitalizuar proceset e punës sipas objektit të veprimtarisë, në përmbushje të kompetencave kushtetuese e ligjore.

Për sa i përket transparencës dhe qasjes në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, janë parashikuar një sërë masash dhe aktiviteteve, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e ndërveprimit me publikun. Transparenca dhe mirë informimi janë në qendër të komunikimit publik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, për të zbatuar vizionin e shpallur prej ngritjes së institucionit, se në fokus të ILD-së është gjetja e balancës midis interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, synon vënien në dukje të aktiviteteve të rëndësishme dhe të informacioneve, për të mos mbetur veç në kornizat e detyrimit ligjor për të dhënë informacion me kërkesë të ankuesit, mbi fazën e shqyrtimit në të cilët ndodhet ankesa apo kërkesa të tjera, por të luajë rol proaktiv në funksion të ndërtimit të marrëdhënieve të besimit me publikun.

Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, është premisë për krijimin e lehtësirave në minimizimin e fluksit të ankesave, të cilat janë jashtë objektit të veprimtarisë, apo janë të papranueshme për shkak të mos përmbushjes së kriterëve ligjore. Evidentimi i të dhënave i shërben nevojave për përmirësim, si në nivel të dhënies së shërbimit ashtu edhe të të kuptuarit nëse ndërgjegjësimi ka arritur të përmbushë qëllimin e tij, që do të thotë të thjeshtimit dhe edukimit të publikut në drejtim të kuptimit të drejtë dhe të qartë të sjelljeve që i japin shkak procedimit disiplinor nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Ndër të tjera janë parashikuar një sërë masash dhe aktiviteteve, të cilat lidhen me fuqizimin e funksionimit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë duke siguruar hartimin dhe zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, integritetin dhe përgjegjshmërinë në menaxhimin operacional, me qëllim garantimin e përmbushjes me efikasitet dhe efektivitet të përgjegjësisë dhe kompetencave kushtetuese të këtij institucioni. Edhe pse Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, nuk është pjesë drejtpërdrejt e sistemit të planifikimit të integruar, plani strategjik është hartuar duke mbajtur në konsideratë kornizën e Sistemit të Planifikimit të Integruar duke iu përshtatur kërkesave të sistemeve IPSIS dhe AFMIS, për të lidhur planin strategjik të politikave me planin buxhetor dhe menaxhimin e financave publike si dhe duke u bazuar në koordinimin midis institucioneve me qëllim arritjen e objektivave që përfshihen në SKZHIE III, si dhe duke zbatuar një qasje sistematike dhe të integruar në zhvillimet e procesit të Integritetit Evropian, kërkesave të Programit Buxhetor Afatmesëm, në programin e investimeve publike dhe atë të ndihmës së huaj.

Zbatimi i planit strategjik të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është mbështetur nga burime financiare, të cilat janë përlllogaritur duke iu referuar tavaneve buxhetore, të alokuar në PBA 2023-2025¹² për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Gjithashtu, në përlllogaritjen e nevojave financiare janë marrë në konsideratë edhe projektet me financim të huaj (në vijim ose të planifikuara) në fushën e drejtësisë.

¹²Udhëzim nr. 22, datë 08.07.2022, i Ministrit të Financave "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2023-2025";

Ndërsa në kuadër të rritjes së transparencës në planifikim, menaxhim dhe kontrollin e fondeve buxhetore, në funksion të garantimit të transparencës janë parashikuar një sërë masash të cilat kanë të bëjnë me publikimin në faqen zyrtare të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë të raporteve periodike të monitorimit të zbatimit të fondeve buxhetore të akorduar në zbatim të ligjit vjetor të buxhetit dhe procedurave të prokurimit publik të kryera.

Ushtrimi i veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas aktiviteteve të koordinuara me dokumentet strategjike, do të bëjë të mundur sjelljen e rezultateve konkrete dhe të besueshme, në funksion të forcimit dhe konsolidimit të pavarësisë, paanësisë, profesionalizmit të institucionit, duke siguruar rritje dhe fuqizim të mekanizmit të kontrollit dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë, duke ekuilibruar pavarësinë, përgjegjshmërinë, eficientën e sistemit gjyqësor dhe ndikimin në rritjen e besimit të publikut.

KREU III –VIZIONI, MISIONI, VLERAT DHE OBJEKTIVAT STRATEGJIKË

Vizioni:

Zbatimi i standardeve kushtetuese dhe evropiane për krijimin e një sistemi solid dhe afatgjatë llogaridhënie e përgjegjshmërie, të pavarur ndaj çdo lloj ndikimi, për funksionimin në mënyrë permanente dhe konsistente duke garantuar balancën midis interesit publik nga një anë dhe pavarësisë së sistemit të drejtësisë nga ana tjetër.

Misioni:

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka për mision forcimin e mekanizmave institucionalë në matjen e performancës së sistemit për cilësinë dhe efikasitetin në dhënien e drejtësisë, me qëllim rritjen e përgjegjshmërisë së subjekteve të hetimit disiplinor në ushtrimin e detyrës nga njëra anë dhe motivimin e rritjen e besimit të publikut dhe organeve që ligji u njeh të drejtën e paraqitjes së ankesave, ndaj sistemit gjyqësor, nga ana tjetër.

Vlerat:

Paanshmëria: Inspektorët duhet të jenë të paanshëm dhe t'i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe kompetencave të dhëna me ligj, në kryerjen e verifikimeve, hetimeve administrative dhe inspektimeve.

Integriteti: Inspektorët gjatë ushtrimit të detyrës duhet të shfaqin integritet të lartë duke shmangur sjellje që mund të cenojnë imazhin e institucionit, apo besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Profesionalizmi dhe kompetenca: Inspektorët duhet të tregojnë dhe të promovojnë standarde të larta të njohurive profesionale dhe etike, me qëllim forcimin e besimit të publikut.

Llogaridhënia: Inspektorët do t'i nënshtrohen një regjimi mbikëqyrjeje, drejtimi, përgjegjshmërie dhe disipline nga organi më i lartë.

Qasja e përgjithshme për objektivat strategjike

Në bazë të vlerësimeve dhe analizës së situatës të paraqitur më sipër, plani strategjik dhe qëllimet strategjike gjenden të përcaktuara në katër objektiva të përgjithshëm, ku secili prej tyre përcakton qëllimin e përgjithshëm, i detajuar në objektiva specifike me një përshkrim të rezultateve të pritshme, që do të arrihen gjatë periudhës së strategjisë bashkë me treguesit e përcaktuar në planin e veprimit, të cilët do të shërbejnë si tregues të qartë (cilësorë dhe sasiorë) në drejtim të vlerësimit të arritjes së secilit objektiv strategjik.

Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.

- **Objektivi Specifik 1.1:** Plotësimi i vendeve vakante në njësinë e inspektorëve dhe zhvillimi profesional.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në plotësimin e vakancave dhe rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore në bashkëpunimin mes institucioneve shtetërore duke kërkuar komandimin e magjistratëve, por edhe përmes ndjekjes së punës për rishikim të kuadrit ligjor që synon kriteret hyrëse në ILD dhe aspekte të rëndësishme të organizimit të brendshëm. Zhvillimi profesional, përmes monitorimit të trajnimeve, veçanërisht me aktorë të huaj, është rezultati i synuar drejt rritjes së kapaciteteve të burimeve njerëzore të ILD.

- **Objektivi Specifik 1.2:** Forcimi i autonomisë financiare dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në hartimin e kërkesave të nevojshme buxhetore, për përmbushjen e veprimtarisë dhe modernizimin e infrastrukturës për punonjësit e ILD-së, si dhe publikun. Ky objektiv ka për qëllim përshtatjen e mjediseve të punës sipas kushteve bashkëkohore dhe ofrimin e lehtësirave në kryerjen e funksioneve dhe veçanërisht duke krijuar ambiente të përshtatshme për marrjen në pyetje të magjistratëve apo personave të tjerë në kuadër të procesit të verifikimit/hetimit disiplinor dhe njëkohësisht duke krijuar kushte për njësinë e pritjes së qytetarëve që paraqiten në ambientet e ILD-së.

- **Objektiv specifik 1.3:** Rishikimi i rregullave të brendshme për ushtrimin e veprimtarisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në rishikimin dhe konsolidimin e rregullave të brendshme të veprimtarisë me synim përshtatjen e tyre me dinamikën e zhvillimeve nga praktika e organeve kompetente që gjykojnë mbi procedurat e ndjekura nga ILD në procedimin disiplinor, por edhe në funksion të përmirësimit të nevojave që diktohen nga praktika dhe nga faktorë të jashtëm.

- **Objektivi Specifik 1.4:** Matja e performancës së njësive përmes monitorimit dhe procesit të vlerësimit të inspektorëve.

Përmes këtij objektivi synohen rezultate në drejtim të matjes së performancës së njësive përbërëse të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë përmes sigurimit të informacionit të plotë statistikor dhe në kohë reale, lidhur me procesin e trajtimit të ankesave/çështjeve kryesisht të depozituara pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe monitorimit të vazhdueshëm,

në funksion të identifikimit të mangësive dhe gjetjen e zgjidhjeve për t'i adresuar mangësitë. Si pjesë përbërëse të këtij procesi janë edhe matja e treguesve sasiorë për vlerësimin e inspektorëve.

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i veprimitarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane.

- **Objektivi Specifik 2.1:** Krijimi i një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në marrjen e disa masave organizative dhe funksionale me qëllim vlerësimin/monitorimin e vazhdueshëm të standardeve të vendosura, në funksion të përmirësimit të proceseve të punës për shqyrtimin e ankesave, kryerjen e hetimeve disiplinore dhe kryerjen e inspektimeve. Treguesit cilësorë për këtë objektiv janë:

- përgatitja e kuadrit rregullator për kryerjen e inspektimeve, ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve të inspektimit si një mjet për matjen e efekteve të inspektimit;
- analizimi i objektit të ankesave në raport me përfundimet e arritura pas shqyrtimit të tyre;
- analizimi i vendimmarrjeve të Këshillave në kuadër të hetimit disiplinor të zhvilluar, në rast të ndryshimit apo rrëzimit të kërkesave për procedim nga këshillat apo dhe praktika gjyqësore;
- monitorim të numrit të kërkesave për procedim që janë shqyrtuar nga këshillat dhe praktika gjyqësore, numri i ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit të ILD-së;
- analizimi i informacionit periodik të gjykatave dhe prokurorive, duke monitoruar informacionet në kohë reale dhe të vazhdueshme, mbi gjendjen faktike të volumit të punës, caktimit të çështjeve, kërkesat për heqje dorë, respektimin e afateve procedurale apo problematikat e ndryshme të raportuara nga gjykatat dhe prokuroritë.

- **Objektivi Specifik 2.2:** Forcimi i kapaciteteve profesionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magjistratëve, subjekte të procedimit disiplinor.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në forcimin e mekanizmave institucionale të bashkëpunimit nëpërmjet nënshkrimit të memorandumëve, ndërmarrjes së tryezave të përbashkëta për diskutime profesionale me synim ngritjen e kapaciteteve për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magjistratëve.

- **Objektivi Specifik 2.3:** Trajtimi i ankesave të ardhura dhe ecuria e backlog-ut.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në marrjen e masave për monitorim të vazhdueshëm të ecurisë së trajtimit, në mënyrë që të shmanget krijimi i stokut të ankesave të ardhura drejtpërdrejt në ILD, si dhe përfundimin e trajtimit të ankesave të përcjella nga institucionet përpara periudhës tranzitore.

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit.

- **Objektivi Specifik 3.1:** Ngritja e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve.

Përmes këtij objektivi synohet të arrihet finalizimi i përgatitjes së Udhërrëfyesit për digjitalizimin e sistemit të drejtësisë që përcakton hapat konkretë drejt zhvillimit të një sistemi të menaxhimit të çështjeve, me kontributin përkatës pranë Grupit Ndërinstitucional të Punës. Duke qenë se ky objektiv strategjik është i ndërlidhur me faktorë të jashtëm, aktivitetet e parashikuar për realizimin e tij konsistojnë në disa masa, të cilat janë të ndërvarura me Udhërrëfyesin e digjitalizimit të sistemit të drejtësisë. Objektivat specifikë do të jenë të rishikueshëm në varësi të miratimit të udhërrëfyesit. Aktualisht, rezultatet e pritshme janë kontraktimi i shërbimeve të ekspertizës për hartimin e termave të biznesit dhe dokumenteve me komponentët përbërës të sistemit, vënia në zbatim e sistemit dhe parashikimi për mirëmbajtjen, si dhe hartimi i rregullave për përdorimin e tij. Treguesit për matjen e këtyre aktiviteteve do të mundësohen përmes miratimeve, të cilat do t'i nënshtrohen konsultimeve me Bordin Drejtues të QTI-së.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik lidhet me aktivitete, të cilat brenda periudhës së zbatimit të planit strategjik do të mundësojnë vënien në punë të sistemit elektronik.

Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

- **Objektivi Specifik 4.1:** Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në përmirësimin e vazhdueshëm të komunikimit me publikun e gjerë, përputhje me programin e transparencës, përmes takimeve me ankuesit, vënies në dispozicion të informacioneve në faqen zyrtare, për aktivitetet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, publikimin e akteve rregullatore, njoftimeve, raporteve të ndryshme, statistikave, rubrikave me informacion të thjeshtuar për publikun të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

- **Objektivi Specifik 4.2:** Ndërgjegjësimi i publikut për rolin dhe funksionet e ILD-së.

Rezultatet e pritshme për këtë objektiv, do jenë zbatimi i aktiviteteve të programit për informimin dhe komunikimin publik në ndërmarrjen e fushatave ndërgjegjësuere për publikun, si dhe vënia në dispozicion i materialeve informuese.

- **Objektivi Specifik 4.3:** Parandalimi i cenimit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ndjekja e procedurave të sinjalizimit.

Rezultati i pritshëm për këtë objektiv specifik konsiston në miratimin e planit të integritetit, i cili i shërben institucionit në identifikimin, vlerësimin dhe parandalimin e tërësisë së rreziqeve, që cenojnë integritetin e institucionit dhe individëve që punojnë në të, si dhe është një dokument pune ku përcaktohen masa konkrete për trajtimin e risqeve të integritetit dhe arritjen e objektivave strategjikë dhe specifikë të institucionit. Nga ana tjetër, ndjekja dhe zbatimi i kuadrit ligjor për sinjalizimin, është masë e vendosur në këtë objektiv strategjik, e cila do të matet përmes numrit të rasteve të paraqitura dhe procedurave hetimore të zhvilluara.

KREU IV - BURIMET FINANCIARE

1. BUXHETI I SHTETIT

Procesi i kostimit është bazuar në konsultimin e dokumenteve kombëtare, përfshirë këtu ligjin nr. 84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, të ndryshuar, Programin Buxhetor Afatmesëm 2023-2025, si dhe konsultimet me aktorët e përfshirë në hartimin e këtij plani strategjik. Është synuar që nëpërmjet këtij procesi të evitohen mbivendosjet me dokumentet e tjerë strategjikë, duke e shoqëruar planin e veprimit me një kostim analitik të secilës masë.

Shpërndarja e burimeve financiare që financojnë aktivitetet e planit të veprimit, do të parashikohet sipas viteve buxhetore për secilin objektiv strategjik dhe objektiv specifik, si dhe aktivitetet.

Kostoja e përgjithshme e përlogaritur për zbatimin e këtij plani strategjik dhe planit të veprimit për periudhën 2023-2025, është vlerën 703,204.94 Lek.

Financimi i planit të veprimit të këtij plani strategjik do të realizohet tërësisht nga buxheti i shtetit në mungesë të sigurimit të mbështetjes financiare edhe nga komuniteti i donatorëve.

Plani i veprimit do të rishikohet në bazë vjetore për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhornuar atë konform ciklit të programimit vjetor buxhetor. Për masa të planit të veprimit ende të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të Programit Afatmesëm Buxhetor dhe buxhetit vjetor.

Gjithashtu, Inspektori i Lartë i Drejtësisë do të identifikojë me komunitetin e donatorëve mundësitë për mbështetje financiare të nevojshme për ato masa, të cilat aktualisht nuk janë të mbuluara financiarisht.

KREU V - MONITORIMI DHE RAPORTIMI

1. Monitorimi

Zbatimi efikas i planit strategjik dhe planit të veprimit 2023-2025, i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, do të sigurohet nëpërmjet një sistemi monitorimi dhe vlerësimi lidhur me zbatimin e objektivave, masave apo aktiviteteve të planifikuara. Ky proces do të bëjë të mundur rishikimin e objektivave, masave apo aktiviteteve, si dhe shpërndarjen e burimeve financiare.

Procesi i monitorimit dhe i vlerësimit do të realizohet nga ana e strukturave të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë nëpërmjet monitorimit në vazhdimësi të nivelit të zbatimit të planit strategjik në përputhje me afatet e parashikuara në planin e veprimit; raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të secilit aktivitet/masë sipas fushës së veprimtarisë së secilës njësi organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; bashkërendimin e aktiviteteve dhe strukturave përkatëse në rastet e vonesave apo mos zhvillimit të aktiviteteve të planifikuara, si dhe harmonizimin me dokumentet e tjerë strategjik dhe burimet financiare të parashikuara për periudhën 2023-2025.

Plani i veprimit që është pjesë e këtij dokumenti strategjik, do të jetë objekt i rishikimit periodik vjetor, proces i cili do të realizohet me kontributin e të gjithë strukturave përbërëse të institucionit, nën koordinimin e njësisë përgjegjëse për shërbimet juridike për të siguruar një vlerësim sa më realist të zbatimit të tij, si dhe për të pasqyruar ndryshimet dhe ecurinë e veprimtarisë së këtij institucioni drejt arritjes së objektivave strategjike dhe atyre specifike të parashikuara paraprakisht.

2. Raportimi

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda një muaji nga miratimi i planit strategjik dhe planit të veprimit do të përcaktojë një sistem raportimi, i cili do të ofrojë një informacion periodik në lidhje me ecurinë e zbatimit të aktiviteteve.

Raportimi i zbatimit të planit të veprimit do të realizohet në baza periodike 6-mujore bazuar në raportet e njësive organizative të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, me qëllim ngritjen e një sistemi efektiv, të unifikuar dhe sistematik të raportimit nga të gjitha njësitë organizative të përfshira në zbatimin e planit strategjik dhe planit të veprimit.

PLANI I VEPRIMIT I STRATEGJISË SË ZYRËS SË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË 2023 -2025

Objektivi Strategjik 1: Konsolidimi i veprimtarisë së ILD-së në mënyrë të pavarur, eficiente dhe profesionale.												
Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse		Periodha e realizimit		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Treguesi cilësor/sasior	
	Njësia përgjegjëse për raportim	Njësia përgjegjëse për zbatim			(në mijë lekë)		(në mijë lekë)		(në mijë lekë)			
			2023		2024		2025					
	Fillimi	Mbarimi	PBA	Donator	PBA	Donator	PBA	Donator				
<i>Objektiv Specifik 1.1: Plotësimi i vendeve vakante në njësinë e inspektorëve dhe zhvillimi profesional</i>												
1	Paraqitja e kërkesave për komandim për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë magjistratë, drejtuar KLGJ dhe KLP	DHASHJ	DHASHJ	2023	2025	33.20	0	33.20	0	33.20	0	Numri i kërkesave dhe numri i vendeve të plotësuara me inspektorë magjistratë të komanduar
2	Shpallja e njoftimit të fillimit të procedurës përzgjedhëse të kandidatëve për pozicionin e inspektorit jomagjistrat	ST	ILD KEV ST	2024	2025	8,824.17	0	8,824.17	0	8,824.17	0	Numri i shpalljeve për plotësimin e vendeve vakante me inspektorë jomagjistratë dhe pozicionet e plotësuara
3	Rritja e kapaciteteve dhe zhvillimi profesional i njësisë së inspektorëve	BNJ	ILD	2023	2025	46.79	0	46.79	0	46.79	0	Numri i trajnimeve të realizuara në funksion të zhvillimit profesional të njësisë së inspektorëve
4	Rritja e kapaciteteve të punonjësve në shërbim civil sipas pozicioneve respektive të punës.	BNJ	Të gjithë punonjësit e shërbimit civil	2023	2025	28.88	0	28.88	0	28.88	0	Planifikimi i nevojave për trajtim dhe numri i trajnimeve të realizuara

5	Përtëritja e kërkesës në Kuvendin e Shqipërisë për miratim të ndryshimeve ligjore për kritereve hyrëse në njësinë e inspektorëve	DHASHJ	ILD	2023	2025	280.36		280.36		140.18		Ndjekja e procedurave parlamentare për shqyrtimin e propozimeve për ndryshime ligjore në ligjin 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar
6	Propozime për ndryshime ligjore në lidhje me ndryshimin e organit miratues, të strukturës organizative të Zyrës së ILD-së	DHASHJ	ILD DHASHJ	2024	2025		0	356.69	0	356.69	0	Hartimi dhe propozimi i ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të Drejtësisë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar

Objektivi Specifik 1.2 Forcimi i autonomisë financiare dhe krijimi i kushteve bashkëkohore për ushtrimin e veprimtarisë.

1	Hartimi i kërkesave buxhetore, sipas nevojave institucionale	SBF	SP SBF	2023	2025	4,867.38	0	4,867.38	0	4,867.38	0	% e kërkesave të përfshira në PBA-në e miratuar
2	Rikonstruksioni i ambienteve të brendshme për pajisjen me ambiente pune për të gjithë numrin e punonjësve, sipas strukturës dhe organikës së miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë.	SSHP	SP SSHP	2023	2025	45,727.00	0	108,458.00	0	-	0	Realizimi dhe përfundimi i zbatimit të projektit për rikonstruksionin e godinës
3	Krijimi i një ambienti të posaçëm për pritjen e publikut dhe për marrjen në pyetje të ankuesve/magjistratëve/dëshmitarëve/personave të tjerë të përfshirë në proces, në kuadër të procesit verifikimit/hetimit disiplinor.	SP Personi/njësia përgjegjës ndjekjen e punimeve sipas kontratës së rikonstruksionit	SP Personi/njësia përgjegjës ndjekjen e punimeve sipas kontratës së rikonstruksionit	2023	2024	-	0	-	0	-	0	Ambient/zyrë e posaçme për pritjen me publikun dhe marrjen në pyetje të palëve në procedurën hetimore. Pajisja me logjistikën e nevojshme.

Objektivi Specifik 1.3 Rishikimi i kuadrit rregullator për ushtrimin e veprimtarisë.

1	Hartimi dhe miratimi rregullores së brendshme pas miratimit të strukturës së re organizative	DHASHJ	DHASHJ	2023	2024	1,411.78	0	1,411.78	0	0	Miratimi i ndryshimit të rregullores së brendshme
2	Hartimi dhe miratimi i rregullores për zgjedhjen dhe emërimin e Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë	DHASHJ	ILD MPI DHASHJ	2023	2024	847.05	0	847.05	0	0	Miratimi i rregullores për procedurat e zgjedhjes së Zëvendësinspektorit të Lartë të Drejtësisë
3	Hartimi i planit vjetor të inspektimit	DHASHJ	ILD MPI DHASHJ	2023	2025	847.05	0	847.05	0	847.05	Miratimi i planit vjetor të inspektiveve
4	Vlerësimi i kërkesave për ndryshim të akteve rregullatore në fuqi	DHASHJ	Çdo njësi propozuese DHASHJ	2023	2025	343.34	0	343.34	0	343.34	Numri i akteve të miratuara
5	Rishikimi i rregullave të vlerësimit etik dhe profesional të inspektorëve	DHASHJ	ILD KEV DHASHJ	2023	2025		0	1,017.25	0	1,017.25	Hartimi i raportit të nevojës për ndryshime dhe miratimi i rregullave të reja
<i>Objektivi Specifik 1.4 Matja e performancës së institucionit përmes monitorimit dhe procesit të vlerësimit</i>											
1	Riorganizimi i strukturës organizative për matjen e performancës	BNJ	SP	2023	2023	1,555.50	0		0	0	Zbatimi i strukturës së miratuar plotësimi i vendeve vakante
2	Përgatitja e kuadrit rregullator për analizim dhe monitorim	DAS	ILD DAS	2023	2024	632.23	0	632.23	0	0	Numri i akteve të miratuara
3	Grumbullimi, përpunimi dhe analizimi i informacionit statistikor	DAS	Njësia e Inspektorëve	2023	2025	2,227.20	0	2,227.20	0	2,227.20	Numri i raporteve periodike të performancës dhe hartimi i vjetarit statistikor i Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
4	Ndjekje të ecurisë së ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit dhe mbylljes së hetimeve të ILD-së në Këshilla	DAS	SP DAS	2023	2025	2,227.20	0	2,227.20	0	2,227.20	Përqindja e ankimeve ndaj vendimeve të arkivimit, hetimit të ILD-së dhe rezultati shqyrtimit në Këshilla

5	Evidencimi i numrit të kërkesave për procedim drejtuar këshillave dhe ecuria gjyqësore, nëse ka	DAS	DAS	2023	2025	1,772.05	0	1,772.05	0	1,772.05	0	Numri ose përqindja e pranimit të kërkesave pa ndryshime/me ndryshime të pjesshme dhe rrëzime nga Këshillat, si dhe numri i rasteve të paraqitura në gjykatë
6	Përgatitja e të dhënave statistikore për vlerësimin e inspektorëve	DAS	KEV SP DAS	2023	2025	1,516.41	0	1,516.41	0	1,516.41	0	Numri i inspektorëve të vlerësuar.

TOTALI

73,187.59

135,737.03

24,247.80

233,172.41

Objektivi Strategjik 2: Fuqizimi i veprimtarisë për matjen e performancës së subjekteve të hetimit disiplinor mbi cilësinë dhe efikasitetin e dhënies së drejtësisë sipas standardeve evropiane.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse		Periodha e realizimit		Buxheti / Kosto		Buxheti / Kosto		Buxheti / Kosto		Treguesi cilësor/sasior	
	Njësia përgjegjëse për raportim	Njësia përgjegjëse për zbatim			(në mijë lekë)		(në mijë lekë)		(në mijë lekë)			
			2023		2024		2025					
			Fillimi	Mbarimi	PBA	Donator	PBA	Donator	PBA	Donator		
<i>Objektivi Specifik 2.1: Krijimi i një sistemi të plotë dhe afatgjatë të përgjegjësisë dhe llogaridhënies së sistemit të drejtësisë</i>												
1	Vlerësimi i tematikave për përfshirje në planin vjetor të inspektimeve (kërkesat e motivuara të KLGJ, KLP, PP dhe MD; dispozita ligjore dhe analiza të brendshme të punës)	DHASHJ	ILD Njësia e Inspektorëve	Dhjetor 2023	Dhjetor 2025	781.19	0	781.19	0	781.19	0	Numri i tematikave dhe sa prej tyre janë përfshirë në planin vjetor të inspektimeve
2	Ndjekja e zbatimit të planit vjetor të miratuar, sipas afateve të realizimit	DAS	Njësia e Inspektorëve	2023	2025	858.93	0	858.93	0	858.93	0	Numri i inspektimeve të planifikuara, sipas afateve të realizimit
3	Ndjekja dhe zbatim i rekomandimeve sipas inspektimeve të kryera	DAS	Njësia e Inspektorëve	2023	2025	499.87	0	499.87	0	499.87	0	Numri ose përqindja e rekomandimeve të përmbushura.

4	Analizim të objektit të ankesave të ardhura dhe mënyra e përfundimit të tyre pas shqyrtimit.	DAS	ILD Njësia e Inspktorëve	2023	2025	858.93	0	858.93	0	858.93	0	Përgatitja e raporteve periodike dhe vjetore
6	Përpunimi dhe analizimi i informacioneve periodike të gjykatave dhe zyrave të prokurorive/KLGJ/KLP/PP	DAS DHASHJ	ILD Njësia e Inspektorëve DHASHJ	2023	2025	2,408.52	0	2,408.52	0	2,408.52	0	Përgatitja e raportit 6 mujor mbi informacionin periodik të gjykatave dhe zyrave të prokurorive
<i>Objektivi specifik 2.2: Forcimi i kapaciteteve profesionale për verifikimin e pasurisë dhe integritetit të magjistratëve, subjekte të procedimit disiplinor.</i>												
1	Forcimi i mekanizmave institucionalë të bashkëpunimit për verifikimin e pasurisë dhe integritetin e magjistratëve	SP	SP	2023	2025	299.31	0	299.31	0	299.31	0	Nënshkrimi i memorandumit të bashkëpunimit me IDKPKI
2	Ndjekja dhe zbatimi i parashikimeve të memorandumit	SP	SP	2023	2025	56.11	0	56.11	0	56.11	0	Raportet e zbatimit
3	Ngritja e kapaciteteve	SP BNJ	SP	2024	2025		0		0		0	Numri i trajnimeve për verifikimin e pasurisë dhe integritetin e magjistratëve
<i>Objektivi Specifik 2.3 Trajtimi i ankesave të ardhura dhe ecuria e backlog-ut</i>												

1	Ndjekja e trajtimit në vijimësi dhe me prioritet të ankesave të ardhura në ILD	DAS	Njësia e Inspektorëve dhe Ndhmës inspektorëve	2023	2025	86,879.22	0	157,156.34	0	157,156.34	0	Numri i ankesave të trajtuara (arkivuara, hetuara kërkesa për procedim) sipas viteve të paraqitura në ILD
2	Ndjekja e trajtimit me prioritet i ankesave të mbartura nga institucionet e mëparshme sipas metodologji së miratur	DAS	Njësia e Inspektorëve dhe Ndhmësinsp ektorëve	2023	2023	35,800.22	0		0		0	Numri ankesave të arkivuara, hetimeve dhe procedimeve disiplinore

TOTALI

128,442.31

162,919.20

162,919.20

454,280.70

Objektivi Strategjik 3: Zhvillimi i sistemit të teknologjisë së informacionit për Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse		Periudha e realizimit		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Treguesi cilësor/sasior	
	Njësia përgjegjëse për raportim	Njësia përgjegjëse për zbatim			(në mijë lekë)		(në mijë lekë)		(në mijë lekë)			
			2023	2024	2024	2025						
	Fillimi	Mbarimi	PBA	Donator	PBA	Donator	PBA	Donator				
<i>Objektivi Specifik 3.1: Ngritja e një sistemi efektiv dhe të unifikuar të teknologjisë së informacionit për menaxhimin elektronik të çështjeve</i>												
1	Hartimi i udhërrëfyesit të sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD	Anëtarët e GP	Anëtarët e GP	2023	2024	251.52	0			0	Delegacioni i BE-së, nga projekti "EU for Justice", implementimi i të cilit mundësohet bazuar në marrëveshjen me titull – Plani i Veprimit 2021 i BE-së për Drejtësinë, financuar nga Programi IPA III, në vlerën 325,000 Euro	Finalizimi i përgatitjes së udhërrëfyesit (roadmap) që përcakton hapat konkretë drejt funksionimit efektiv të Sistemit të Menaxhimit të Çështjeve
2	Hartimi i dokumentit të termave të biznesit për sistemin e menaxhimit të çështjeve në ILD	STI	SP STI	2024	2024	0				0	Kontraktimi i shërbimeve të ekspertizës për hartimin e termave të biznesit dhe miratimi i tij	

3	Hartimi i dokumentit me specifikimet teknike për zhvillimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në ILD	STI	SP STI	2024	2024	0		0		0	Kontraktimi i shërbimeve të ekspertizës për hartimin e dokumentit me komponentët përbërës të sistemit, ndërvarësitë dhe ndërveprimi midis tyre.
4	Zhvillimi i sistemit dhe mirëmbajtja e tij.	STI	STI	2024	2025	0		0		0	Vënia në zbatim e sistemit dhe parashikimet për mirëmbajtjen e tij
5	Hartimi i rregullores së roleve dhe përdorimit të sistemit	DHASHJ	DHASHJ STI	2025	2025	0		0		612.31	Miratimi i rregullores së përdoruesve të sistemit

TOTALI

251.52

612.31

863.83

Objektivi Strategjik 4: Rritja e transparencës dhe aksesit të publikut në veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Masat / Aktivitetet e parashikuara	Struktura Përgjegjëse		Periudha e realizimit		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Buxhetimi / Kosto		Treguesi cilësor/sasior	
	Njësia përgjegjëse për raportim	Njësia përgjegjëse për zbatim			(në mijë lekë)		(në mijë lekë)		(në mijë lekë)			
			2023		2024		2025					
			Fillimi	Mbarimi	PBA	Donator	PBA	Donator	PBA	Donator		
<i>Objektivi Specifik 4.1: Rritja e transparencës nëpërmjet komunikimit dhe bashkëpunimit me publikun.</i>												
1	Takime me ankuesit dhe asistencë në plotësimin e formularit të ankesës apo çështje të tjera	SAMP	SAMP	2023	2025	2,540.64	0	2,540.64	0	2,540.64	0	Numri i takimeve të realizuara
2	Publikimi i Urdhrave të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, njoftimet dhe raporte të ndryshme, në faqen zyrtare të ILD	STI	SP SAP	2023	2025	20.97	0	20.97	0	20.97	0	Numri i publikimeve të realizuara për urdhrat/njoftimet/raportet
3	Publikimi i buletineve dhe vjetarit statistikor	STI	DAS	2023	2025	20.97	0	20.97	0	20.97	0	Numri i buletineve të publikuara dhe vjetarit statistikor

4	Publikimi i informacionit për funksionimin e ILD-së në kuadër të programit të transparencës	SAMP	SP Të gjitha njësitë	2023	2025	20.97	0	20.97	0	20.97	0	Numri i dokumenteve të publikuara
<i>Objektiv Specifik: 4.2 Ndërgjegjësimi i publikut për rolin dhe funksionet e ILD-së</i>												
1	Konceptimi dhe realizimi i këndit informativ	SAMP	SP SAMP	2023	2025	-	0	-	0	-	0	Numri i njoftimeve apo informacioneve të nevojshme
2	Zhvillimi i aktiviteteve informuese/edukuese në kuadër të programit për informimin dhe komunikimin publik të Zyrës së ILD-së	SAMP	SP SAMP	2023	2025	329.63	0	329.63	0	329.63	0	Numri i aktiviteteve të realizuara
<i>Objektiv Specifik: 4.3 Parandalimi i cenimit të integritetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë dhe ndjekja e procedurave të sinjalizimit</i>												
1	Hartimi i planit të integritetit për ILD	DHASHJ	SP Të gjitha njësitë	2023	2025	5,189.61	0		0		0	Miratimi i planit të integritetit
2	Ndjekja dhe zbatimi i ecurisë së planit të integritetit	SAMP	SP Të gjitha njësitë	2023	2025	104.87	0	104.87	0	104.87	0	Raporte monitorimi të zbatimit të planit

3	Zhvillimi i procedurave në kuadër të sinjalizimit e veprimeve ose praktikave korruptive të punonjësve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë	SP	SP NJPS	2023	2025		0	292.10	0	292.10	0	Numri i procedurave të zhvilluara të sinjalizimit dhe rezultatet e procedurave
---	--	----	------------	------	------	--	---	--------	---	--------	---	--

TOTALI

8,227.67

3,330.16

3,330.16

14,888.00

TOTALI I BUXHETIMIT TE PLANIT TE VEPRIMIT 2023 -2023

703,204.94